



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1733 Prot.

Tiranë, më 04.07 2023

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 49 datë 04.07 2023

“PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR 48 DATË 30.06.2023 “PËR MIRATIMIN E  
PAGAVE TË PUNONJËSVE NDIHMËS AKADEMIK ME KARAKTER  
ADMINISTRATIV DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË  
TIRANËS”**

Bordi i Administrimit të Universitetit Sporteve të Tiranës, mbështetur në:

- Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”;
- Ligji nr.10/247 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve“, të ndryshuar;
- Udhëzimin i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit të Lartë”;
- Vendimin i Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”;
- VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësëve civil dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”.
- VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa insitucione të administratës publike”;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, dhe të niveleve të pagave nënpunësëve civil/nënpunësve, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të sugjerimit të MAS përcjell përmes e mail të datës 29.06.2023 dhe në Relacionin nr. 1682/1 prot, datë 30.06.2023, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit dhe Drejtorisë së Finacës dhe Buxhetit të UST, në Vendimin nr 48 datw 30.06.2023 Bordi i Administrimit me Vendim Qarkullues ,

**VENDOSI:**

**Pas pikës 2** të Vendimit nr.48 datë 30.06.2023 “Për miratimin e pagave të punonjësve ndihmës akademik me karakter administrativ dhe administrativ në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, shtohet pika 2/1, më përmbajtje, si vijon:

“2/1. Efektet financiare për pagat e punonjësve ndihmës akademik me karakter administrativ dhe administrativ, të miratuara sipas pikës 1 dhe 2 të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.48, datë 30.06.2023 fillojnë nga data 01 prill 2023.

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**ARTUR ÇOBANI**

